



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECANI



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër  
12- Zyrtarisht /2019  
Deçan, 12-12.2019

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit  
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslija 

Nga : Shefi i Drejtorisë Z. Hasan Hulaj 

Lënda: Raport Pune për periudhën 04 Janar – 12 Dhjetor 2019, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhë 04 Janar – 12 Djetor 2019 për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.



## **R A P O R T P U N E**

### ***Për periudhën 04 Janar 2019– 12 Dhjetor 2019 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan***

#### **1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentën e ndryshimeve kadastrale**

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2019 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **489** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **489** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa edhe **2** kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referentja për ndryshime kadastrale e cila konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurno duke i fut të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-es

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoresh juridike dhe së bashku me Referentën për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

## 2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **201** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesë së palëve prej të cilave të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **3** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **10** historiate sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **290** kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **5** raste nga domeni pronësor juridik e sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të Komunës. Si dhe kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyre.

## 3. Referenti për pranimin e palëve


Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **2671** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës.

Për hir të thjeshtësimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve këtij raporti po ja bashkëngjirim edhe formën tabelore të lëndëve të pranuar sipas muajve dhe llojit të kërkesave .

<b>Lloji i lëndëve</b>	<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>	<b>Prill</b>	<b>Maj</b>	<b>Qershor</b>	<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>	<b>Totali</b>
<b><i>Ndërrimi i pronarëve</i></b>	32	25	45	32	41	23	39	73	43	43	33	10	439
<b><i>Hipotekat</i></b>	4	6	2	7	10	3	3	5	7	3	5	1	56
<b><i>Azhurimi i lëndëve -Tereni certifikatat</i></b>	17	2	20	11	16	12	21	20	27	27	18	10	201
<b><i>certifikatat</i></b>	158	145	232	168	196	794	237	241	183	161	126	30	2671
<b><i>Totali për Muaj</i></b>	<b>211</b>	<b>178</b>	<b>299</b>	<b>218</b>	<b>263</b>	<b>832</b>	<b>300</b>	<b>339</b>	<b>260</b>	<b>234</b>	<b>182</b>	<b>51</b>	<b>3367</b>

Raportin e përpiloi :  
Shefi i kësaj Drejtorie  
Hasan Hulaj




Drejtori  
Agron Muslijaj

